

UDHËZIM
Nr. 65, datë 19.9.2014

**PËR BASHKËRENDIMIN NË
MONITORIMIN E ZBATIMIT TË
LIGJIT PËR MBROJTJEN E
SHËNDETIT NGA PRODUKTET E
DUHANIT, NGA TRUPAT
INSPEKTUESE**

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi”, të ligjit nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “ Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar;

UDHËZOJ:

TË PËRGJITHSHME

I. HYRJE

Misioni i Inspektoratit Qendror është përmirësimi i efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Për arritjen e misionit të tij, Inspektorati Qendror bashkërendon veprimtarinë e inspektorateve shtetërore e vendore, si dhe të trupave inspektuese, duke mbikëqyrur zbatimin e ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të legjislacionit të zbatueshëm sektorial, nga inspektoratet shtetërore/vendore.

Qëllimi i veprimtarisë së inspektimit është krijimi i një mjedisi të përgjithshëm rregullator ligjor, jo vetëm për të rritur transparencën dhe mbështetje në veprimtarinë e trupave inspektuese, por për të garantuar sigurinë në mbrojtjen të shëndetit publik.

Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në zbatim të ligjit nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar”, janë përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, si vijon:

- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtim.

II. PROGRAMIMI I INSPEKTIMEVE

Gjatë veprimtarisë së tyre inspektuese, inspektoratet shtetërore/trupat inspektuese përgjegjëse, në programet e tyre inspektuese, përveç mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit të tyre sektorial, gjatë ushtrimit të kontrollit, duhet të mbikëqyrin edhe zbatimin e ligjit nr. 76/2014.

2.1 Zbatimi i ligjit nr.76/2014, duhet të jetë një proces mbikëqyrës inspektimi i vazhdueshëm nga inspektoratet shtetërore përgjegjëse, si dhe trupat inspektuese të cilat duhet të marrin masat që në programimin e inspektimeve të tyre të mbikëqyrret, përveç përmbushjes së kërkesave të legjislacionit të tyre sektorial, edhe zbatimi i këtij ligji, ku në programet vjetore dhe mujore të punës së këtyre inspektorateve të shtohet në listat e verifikimit të tyre, edhe verifikimi i zbatimit të këtij ligji si rubrikë më vete.

**III. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË
LIGJIT**

3.1 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 76/2014 duhet të jetë objekt kontrolli i programeve të inspektimeve nga të gjitha institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji, në të gjitha mjediset ku ndalohet pirja e duhanit.

3.2 Trupat inspektuese të bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3.3 Nëse gjatë veprimtarisë inspektuese identifikohen subjekte, të cilat nuk kanë marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji dhe që paraqesin një mundësi reale më të madhe për moszbatimin, ose një zbatim preferencial të ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, trupat inspektuese duhet të njoftojnë menjëherë me shkrim Inspektoratin Qendror, i cili, me marrjen e këtij njoftimi, ia përcjell atë inspektoratit kompetent.

3.4 Inspektorati Qendror, si institucion përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë së trupave inspektuese për zbatimin e ligjit nr. 76/2014, në mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore/vendore, për zbatimin e legjislacionit në fuqi për inspektimin, do të ketë objekt të mbikëqyrjes së saj jo vetëm respektimin e procedurave inspektuese, në përmbushje të legjislacionit të posaçëm sipas fushës së inspektimit dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre, por edhe monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 76/2014, si efekt i këtij udhëzimi.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Ilir Zela

